



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përftim Kontrolli: **Balfin SHPK / ITD SHPK / Investment Joti - Infosoft Group SHPK**

Në datën 28 Mars 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Kontratë për Shitjen e Kuotës”. Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 19 Dhjetor 2016, është realizuar përfthimi i kontrollit të shoqërisë ITD SHPK (“Target”) nga shoqëria Balfin SHPK (“Blerësi”) me anë të blerjes së masës 49% të kapitalit nga shoqëria Investment Joti- Infosoft Group SHPK “Shitësi”.

Ky njoftim plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Balfin SHPK:** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila vepron kryesisht në fushën e ofrimit të shërbimit të konsulencës në fusha të ndryshme, investim, pjesëmarrje në kuota, menaxhim të qendrave tregtare , import –eksport , etj..
- **ITD SHPK:** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar veprimtaria e së cilës lidhet kryesisht me tregtim pajisjesh kompjuterike, software dhe hardware dhe pajisje zyrash, shërbim marketing, distribucioni, konsulencë dhe studim tregu, etj..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksi i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe nenin 12, pika 1 dhe 2 , të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al